

**AKT THEMELIMI**  
**i Shoqërisë "Bagit Albania" Sh.p.k.**

Sot, me datë 05 / 04 /2022,

**Z. Damjan Balla**, shtetas shqiptar, atësia Selim, lindur më 28/08/1997, në Burrel, banues në Tiranë, mbajtës i dokumentit kartë identiteti me nr. 032615972 me ID J70828005N, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

**Z. Klevi Dine**, shtetas shqiptar, atësia Albert, lindur më 13/09/1995, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i dokumentit kartë identiteti me nr. 032394135 me ID J50913063L, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**Bagit Albania " Sh.p.k.** (më poshtë referuar si "Shoqëria").

**NENI 1**

**EMËRTIMI**

Emri i Shoqërisë është "**Bagit Albania" Sh.p.k.**

**NENI 2**

**SELIA**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: **Rruga "Muhamet Gjollësia", Pall 4, Shkalla 3, Kati 1, Ap 13, Tiranë, Shqipëri.**

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

**NENI 3**

**KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

**NENI 4**

**OBJEKTI**

**Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:**

Tregti, Import - eksport, te pajisjeve elektronike, elektro-shtepiake, kancelari, aksesoreve te ndryshem si ora, elektronike dhe jo elektronike, canta, syze, produktet e duhanit IQOS, produkte kozmetike etj. Tregti biçikletash, skutera elektrike dhe cdo paisje te ngjashme me to, si dhe servisin e tyre, servis kompjuteresh dhe pajisje telekomi. Tregeti, import eksport te cdo pjese kembimi per to. Shitja nepermjet platformave online Ndermjetesim tregtar. Ofrimi i sherbimeve te konsulences per palet e treta (te cilet perfshijne pa kufizime konsulencen e natyres manaxheriale, komerciale, logjistike, etj.) dhe konsulenca te tjera ne baze te ligjit shqiptar per subjekte brenda dhe jashte vendit.

*Klevis Dine*

*Damjan Balla*

Ne pergjithesi shoqeria mund te kryejë çdo veprimtari te nevojshme e te dobishme te lejuar nga ligji per relizimin e objektit te aktivitetit te saj.

Shoqeria mundet gjithashtu te ushtroje cdo lloj tjetër biznesi apo aktiviteti te ligjshem dhe/ose mund te angazhohet ne cdo veprimtari te ligjshme ose aktivitet te lejueshem nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

## **NENI 5**

### **KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakut themelues në vlerën 100.000 (një qind mijë) Lekë dhe përbëhet nga 2 (dy) kuota.

Kapitali themeltar përbëhet si më poshtë:

- **Z. Damjan Balla**, zoteron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 50.000 (pesedhjetë mijë) Lekë dhe 50.000 (pesedhjetë mijë) Lekë të kapitalit themeltar.
- **Z. Klevi Dine**, zoteron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 50.000 (pesedhjetë mijë) Lekë dhe 50.000 (pesedhjetë mijë) Lekë të kapitalit themeltar..

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra me shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

## **NENI 6**

### **ORGANET E SHOQËRISË**


Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

-Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

-Organi i vetëm administrativ i shoqërisë janë Administratoret.

**Z. Damjan Balla**, shtetas shqiptar, atësia Selim, lindur më 28/08/1997, në Burrel, banues në Tiranë, mbajtës i dokumentit kartë identiteti me nr. 032615972 me ID J70828005N, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

**Z. Klevi Dine**, shtetas shqiptar, atësia Albert, lindur më 13/09/1995, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i dokumentit kartë identiteti me nr. 032394135 me ID J50913063L, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.



## **NENI 7**

### **LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM**

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

## **NENI 8**

### **DISPOZITA FINALE**

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaket themelues te shoqërisë duke autorizuar Administratoren, **Z. Damjan Balla**, dhe **Z. Klevi Dine** për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

### **ORTAKET THEMELUES**

**DAMJAN BALLA**



**KLEVDINE**

